



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 04

Datë: 28. 01. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Valmira Semnai, drejtoreshë u.d., e ZRPPC.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së;**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve Nr. 85 dhe 86 /2021;**
- 3. Aktivitetet e SKQZ;**
- 4. Aktivitetet e ZRPPC;**

-Kërkesë për shtyrjen e afatit për mbajtjen e Kuvendit Zgjedhore nga PP-ja “Stranka Demokratske Akcije”

- 5. Raport i Këshillave të KQZ-së:**

- Këshilli për Çështje Ligjore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Kërkesës për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Prishtinë
- **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

-Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor Financiar të KQZ-së, për vitin 2021

6.Të ndryshme.

1. **Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi,** Kryesues i mbledhjes së KQZ-së: E hapim mbledhjen e katër të KQZ-së, e keni rendin e ditës. Sot mungojnë Gordana për shkaqe shëndetësore, dhe Ilir Gashi e Ibrahim Selmonaj. Jemi të njoftuar lidhur me arsyet. Nga LDK, ende nuk kemi përfaqësim. A kemi diçka tjetër për rend të ditës...?

Sami Kurteshi, në pikën e pestë lidhur me “Këshillin Ligjor”, tha se kanë ardhur më vonë edhe katër kërkesa për zëvendësim nga komuna e Podujevës. I kemi shqyrtuar dhe, propozojmë të futen në aprovim.

Në vazhdim, me shtatë vota për, u miratuan procesverbalet nr. 85, dhe 86 /2021:

2. **Aktivitetet e SKQZ:**

Burim Ahmetaj, tha se Sekretariati ka zhvilluar aktivitetet organizative, si shënimi i ditës globale të zgjedhjeve më 3 shkurt, dhe do të organizohen dy aktivitete. Për shkak të pandemisë, sidomos në ligjëratat që do të organizohen nga KKZ-të me të rinjtë rreth informimit të tyre, ne kërkojmë anulimin e tyre në bazë të të gjitha rrethanave, dhe situatës së rënduar...

Lidhur me regjistrimin e pasurisë jo financiare të KQZ-së, ky proces do përmbillet sot. Mbas përfundimit, formohet komisioni për vlerësimin e gjithë pasurisë, dhe pastaj do të vazhdojmë me procedurat tjera.

Rreth pagesave të trupave zgjedhore, kemi pranuar kthimet nga banka, informacionet dhe bëhet fjalë për rreth 500 persona nga trupat zgjedhorë të angazhuar në zgjedhjet lokale, dhe se, për shkak të gabimeve kryesisht teknike, pagesat nuk kanë mundur të procedohen.

Bëhet fjalë për rreth “40 000” euro detyrime...

Në javët e ardhshme, do ta kemi raportin e detajuar në këtë drejtim, dhe pastaj të fillojmë me pagesat...

Arianit Elshani, tha se kjo çështje me të vërtetë duhet të përmbillet sepse kemi detyrime ndaj atyre që kanë punuar në zgjedhje, ndërsa shtroi pyetje rreth regjistrimit të pasurisë jo financiare, që e konsideroi

si një proces të stërzgatur. Mirë do ishte, të kemi një datë të fundit në këtë aspekt. E treta, rreth ditës globale të zgjedhjeve, Elshani tha se ndoshta në ndonjë komunë mund të gjenden metoda, ndoshta online por, edhe mund të shtyhet tutje si aktivitet..

Sami Kurteshi, po ashtu tha se “regjistrimi i pasurisë” është edhe kërkesë e auditorit gjeneral, dhe se po shpresoj të kryhet gjatë javës, kurse rreth pagesave të trupave zgjedhor z. Kurteshi tha se ka marrë një mesazh që, personit nuk i është paguar një pagesë prej “70 euro” qysh nga zgjedhjet e vitit 2017...

Alim Rama, tha se kjo është shqetësuese dhe se, personat që kanë punuar duhet të paguhen. Ata, po ankohen më shumë se nuk kanë “përgjigje” nga zyrtarët tanë, sidomos ata komunal dhe se të bëhet një shkresë që, ata të kenë përgjigje...

Ai, dha sugjerime se s’i të përfundohet ky proces, në mënyrë që të përfundohet ky proces. Z. Rama, tha se ndoshta, mund të gjenden mënyra që të mos shtyhen të gjitha mundësitë rreth informimit dhe edukimit të të rinjve, sepse ata duhet të jenë sa më të informuar...

Krye shefi, **z. Ahmetaj**, tha se do t’i adresojmë çështjet teknike që lidhen me pagesat e trupave zgjedhorë, dhe se jemi në bashkëpunim edhe me KKZ-të, por që na duhet edhe një vendim i KQZ-së për pagesa: alokim të mjeteve...

Rreth ligjëratës lidhur mbi ditën globale të zgjedhjeve, edhe mbas kësaj dite ligjëratat mund të organizohen në këtë gjashtëmujorë, duke shpresuar që do të kemi edhe një situatë më të shtendosur nga covid...

Čemailj Kurtiši: Pajtohem. Efektive do të ishte që, të gjendet një moment ma i mirë dhe se, të shtyhet ligjërata. Në anën tjetër, çështjet rreth pagesave, në bashkëpunim me KKZ-të, kjo çështje mund të procedohet edhe teknikisht më shpejtë. Nuk e shoh si problem, dhe të mos kemi këso probleme sepse, edhe unë jam i njoftuar që njerëzit kanë punuar, por që nuk janë paguar...

Fazli Stollaj, tha se planifikimi për mbajtjen ligjëratës të pezullohet, sepse numri i të infektuarave po shtohet... Kurse, rreth pagesave personat duhet të paguhen, dhe në të ardhmen të gjendet një mënyrë më efikase...

Kreshnik Radoniqi: Mendoj që, edhe sipas diskutimeve “ligjërata” të shtyhet, jo të anulohet, dhe se Sekretariati ta shoh mundësinë kur do të mbahet...

Me votim unanim, u vendos që ky aktivitet i planifikuar të mbahet në ditën e zgjedhjeve, “Ligjërata mbi informimin dhe edukimin e votuesve” që lidhen me proceset zgjedhore, të shtyhet dhe të mbahet në rrethana tjera.

3. Aktivitetet e ZRPPC

Kërkesë për shtyrjen e afatit për mbajtjen e Kuvendit Zgjedhore nga PP-ja “Stranka Demokratske Akcije”:

Valmira Selmani, ud., e ZRPPC, tha se zyra po vepron gjatë janarit rreth “azhurnimeve” vjetore. Ne, i kemi informuar partinë, dhe se afati i fundit, është 31 janari 2022. Kemi filluar pranimet e raporteve...

Po ashtu, kemi pranuar edhe kërkesën e Grupit Parlamentar Multietnik nga Kuvendi i Kosovës që kanë kërkuar shumën prej 10% të mjeteve që e njëjta shumë të menaxhohet nga KQZ. Ndërsa, kjo siç e dimë, është refuzuar, dhe më 14 janar ne, e kemi njoftuar grupin me këtë vendim...

Janë pranuar edhe kërkesa për shtyrje të kuvendeve nga disa subjekte, dhe për këtë KQZ tashmë ka vendosur, dhe se, kemi njoftuar edhe të gjitha subjektet që kanë fituar ulëse në asambljetë komunale nga zgjedhjet e 17 tetorit për kthimin e mjeteve... Jemi duke punuar në këtë drejtim, me faktorët relevantë...

Kemi dorëzuar edhe planin e aktiviteteve që ndërlidhen me zyrën e prokurimit 2021, dhe kemi pranuar një kërkesë nga Këshilli Prokurorial lidhur me verifikimin e disa kandidatëve në pozitën kandiduese për “Prokuror të Shtetit”...

Po ashtu, Selmani raportoi edhe rreth gjobave që kanë partinë politike...

Sami Kurteshi, duke u ndërlidhur me këtë pikë, tha se subjekti politik “Stranka Demokratske Akcije”, ka dërguar kërkesë në Këshillin Ligjor për shtyrjen e afatit për mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor. Ne, e kemi trajtuar dhe se pas dëgjimit të zyrës, si dhe bazuar në vendimin e KQZ-së, rekomandojmë për aprovim...

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, kush është për që kërkesa e subjektit politik “Stranka Demokratske Akcije” për shtyrjen e afatit për mbajtjen e kuvendit zgjedhor të aprovohet ?

Aprovohet, me vota unanime

4. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i Kërkesës për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Prishtinë:

Sami Kurteshi: Ndër të tjera, këshilli ka trajtuar edhe kërkesën për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Prishtinë, dhe siç kërkova në fillim, edhe të Podujevës. I kemi aprovuar në këshill, në mënyrë unanime dhe ne rekomandojmë për aprovim.

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Prishtinës, i dorëhequri Izet Sadiku, zëvendësohet nga Dasmor Durmishi nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Podujevës, i dorëhequri Avni Fetahu, zëvendësohet nga Ragip Fetahu nga subjekti politik Lëvizja “Vetëvendosje!”. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Podujevës, i dorëhequri Vigan Salihu, zëvendësohet nga Bahri Blakcorri nga subjekti politik Lëvizja “Vetëvendosje!”. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Podujevës, i dorëhequri Pajtim Balaj, zëvendësohet nga Xhevdet Maloku nga subjekti politik Lëvizja “Vetëvendosje!”. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Podujevës, i dorëhequri Bahri Selimi, zëvendësohet nga Haki Rudari nga subjekti politik Lëvizja “Vetëvendosje!”. Kush është për...?

Miratohet...

Të gjitha këto “miratime”, u votuan me shtatë vota, aq sa prezantonin në mbledhje anëtarë të KQZ-së.

5. Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor Financiar të KQZ-së, për vitin 2021:

Fazli Stollaj, në mungesë të kryesues së këshillit, paraqiti raportin e këtij këshilli. Ai tha se, është shqyrtuar raportin vjetor financiar të KQZ-së për vitin 2021 dhe se, në raport janë përfshirë shpenzimet sipas kategorive ekonomike, ndryshimet që kanë ndodhur për shkak të zgjedhjeve, detyrimet e papaguara, të dhënat kontingjente, gjendja e rekomandimeve të autorit etj.

Ne, tha z. Stollaj, e kemi miratuar me shumicë votash.

Sami Kurteshi, lidhur me raportin, konkretisht për nenin 13 të Ligjit mbi shpenzimin e financave, dhe ai kërkoi shpjegime. Gjithashtu, ai foli edhe rreth tabelave në raport, aspektet teknike të formatit të raportit, gjithnjë duke kërkuar më shumë “shpjegime” të përpilimit të raportit: ndërlidhet e të dhënave, shpjegimet, kuptueshmërinë e tyre...

Alim Rama, kërkoi vendosjen e “indekseve” në raport lidhur me shpjegimin e shkurtesave, dhe po ashtu, ai u ndërlidh edhe rreth raportit – rekomandimeve të zyrës gjeneralë të auditimit. Në kontekst, z. Rama, tha se, nuk janë zbatuar të gjitha rekomandimet dhe se në raportin tonë duhet të përcillen ato, dhe ne të jemi më transparent...

Lidhur me këto çështje, në fakt rreth përmbajtjes dhe formatit të raportit, krye shefi **Ahmetaj** dhe znj. **Miradije Meha**, drejtoreshë e DAP-it dhanë shpjegime: qoftë për ligjore, teknike, dhe qoftë për ato financiare.

Në vazhdim, diskutuan më tej: **Sami Kurteshi**, i cili nuk u pajtua me këtë format dhe me elementit e raportit dhe se, kërkoi që raporti të qartësohet, përndryshe nuk do ta aprovojë...

Gjithashtu, diskutoi edhe **Alim Rama**, në kontekst të dhënies së më shumë shpjegimeve dhe qartësisë në raport. Gjithashtu, diskutuan edhe:

Arianit Elshani, Qemajl Kurtesh, Kreshnik Radoniqi, Burim Ahmetaj.

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, kush është për miratimin e këtij raporti ?

Me katër vota për, një kundër dhe dy abstenime, raporti nuk miratohet.

Kreshnik Radoniqi: E keni obligim që vërejtjet që i dhamë, të e shqyrtoni dhe të na e sillni pastaj, dhe do ta votojmë përmes imellit për shkak të afatit të përcaktuar...

Të ndryshme !

Rifat Krasniq, bëri vërejtje se pse raporti nuk është sjellë më herët por në momentet e fundit, dhe se, ai tha se është kundër që KQZ të merret me këto çështje, kur njerëzit në Sekretariat kanë përgjegjës, drejtorë, ekspert me përvojë, janë profesionalë...

Ky, është gabim...

Për KQZ

Kreshnik Radoniqi, kryetar
